



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 800/18 prot.,

Datë 25.05.2026

V E N D I M
Nr. 708/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.05.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 525/2026, datë 22.04.2026 në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra”, me nr. REF-64006-10-07-2025, me objekt “Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj”, me fond limit: 83,904,000 (tetëdhjetë e tre milion e nëntëqind e katër mijë) lekë pa TVSH, ose 867,404 (tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e katër) Euro pa TVSH, zhvilluar në datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “MEDFAU” SHPK me NIPT J93610823R dhe adresë: LAGJA 5, Tiranë

Operatori ekonomik “Evita” SHPK me NIPT L31714005J dhe adresë: Rruga Sami Frashëri, Nr. Pasurie 7/120- N1, Zona Kadastrale 8270, Vol. 28, faqe 155, Tiranë

Operatori ekonomik “SWISSMED” SHPK, me Nipt. K81323024G dhe adresë Njesia Bashkiake nr.11, Rruga Dritan Hoxha, Ndertesa 92, seksioni 4, Hyrja 28, Kodi Postar 1026, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 22.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 525/2026, ku vendosi:

[.....]

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “MEDFAUN” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra”, me nr. REF-64006-10-07-2025, me objekt “Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj”, me fond limit: 83,904,000 (tetëdhjetë e tre milion e nëntëqind e katër mijë) lekë pa TVSH, ose 867,404 (tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e katër) Euro pa TVSH, zhvilluar në datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a
2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Evita” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra”, me nr. REF-64006-10-07-2025, me objekt “Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj”, me fond limit: 83,904,000 (tetëdhjetë e tre milion e nëntëqind e katër mijë) lekë pa TVSH, ose 867,404 (tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e katër) Euro pa TVSH, zhvilluar në datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.

3. *Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “SWISSMED” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra”, me nr. REF-64006-10-07-2025, me objekt “Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj”, me fond limit: 83,904,000 (tetëdhjetë e tre milion e nëntëqind e katër mijë) lekë pa TVSH, ose 867,404 (tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e katër) Euro pa TVSH, zhvilluar në datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a*
4. *Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertat e operatorëve ekonomikë “MEDFAU” SHPK dhe “Evita” SHPK, sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim duke i kualifikuar ata*
5. *Ngarkohet zyra e financës të kryej veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “SWISSMED” SHPK.*
6. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Evita” SHPK.*
7. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “MEDFAU” SHPK*
8. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
9. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.” [...]

I.2. Me shkresën nr. 2227/3 prot., datë 21.05.2026, protokolluar me tonën nr. 800/15 prot., datë 22.05.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 525/2026 datë 22.04.2026 duke i bashkëlidhur shkresës dhe procesverbalin e datës 20.05.2026 ‘Për rivlerësimin e ofertave të paraqitura në procedurën e prokurimit Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj’ për QSUT REF-64006-10-07-2025’.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 2227/3 prot., datë 21.05.2026, protokolluar me tonën nr. 800/15 prot., datë 22.05.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, njofton se ka

zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 525/2026 datë 22.04.2026 duke i bashkëlidhur shkresës dhe procesverbalin e datës 20.05.2026 ‘Për rivlerësimin e ofertave të paraqitura në procedurën e prokurimit Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj’ për QSUT REF-64006-10-07-2025”.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme dhe verifikimit të raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik në përputhje me vendimin e KPP Nr. 525/2026, datë 22.04.2026

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra”, me nr. REF-64006-10-07-2025, me objekt “Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj”, me fond limit: 83,904,000 (tetëdhjetë e tre milion e nëntëqind e katër mijë) lekë pa TVSH, ose 867,404 (tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e katër) Euro pa TVSH, zhvilluar në datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

